



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1349, date 28.07. 2010

Për

“Mbylljen e procedimit administrative për zgjidhje mosmarreveshje interkoneksioni të filluar me VKD nr.1261, date 28.04.2010 midis sipërmarrësit Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k dhe Altelecom sh.a”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 28.07.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Mbylljen e procedimit administrative për zgjidhje mosmarreveshje interkoneksioni të filluar me VKD nr.1261, date 28.04.2010 midis sipërmarrësit Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k dhe Altelecom sh.a”, të shoqëruar nga:
- Raport përmbledhës (**Raporti**);
- Projekt Vendim i KD (**Projektakti**);
- Dokumentet shkresore të paleve (**Provat, pretendimet**):

BAZA LIGJORE :

1. Neni 120 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);

2. Neni 66, neni 135 e vijues te ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore per Aksesin dhe Interkoneksionin e miratuar me VKD nr, 416, date 7.12.2007;
4. Rregullore per Procedurat e Zjidhjes se Momarreveshjeve e miratuar me VKD nr. 1296, date 11.06.2010;
5. RIO e Albtelecom miratuar nga AKEP me 10.02.2009;
6. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24.04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918.

K Ë SH I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, te perbere nga:

- Ankim Administrativ i sipermarresit Alban Tirana Nascendo sh.p.k (ne vijim referuar edhe ATN) paraqitur me shkrese nr.4 prot, date 25.02. (**Ankimi Administrativ**);
- Shkrese e AKEP nr. 765/1,date 08.03.2010 drejtuar Albtelecom sh.a “Mbi ankesen e sipermarresit Alban Tirana Nascendo”;
- Shkrese e Albtelecom nr.1056/2, date 25.03.2010 drejtuar AKEP.
- Shkrese e Alban Tirana Nascendo nr.7/1 prot, date 29.03.2010;
- Shkrese e Alban Tirana Nascendo nr. 8 prot, date 29.03.2010;
- Vendim i Keshillit Drejtues nr. 1261, date 28.04.2010 “Per fillimin e procedimit administrativ per zgjidhje mosmarreveshje interkoneksioni midis sipermarresit Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k dhe Albtelecom sh.a”;
- Shkrese e Alban Tirana Nascendo nr. 12 prot, date 14.05.2010 mbi pretendimet me shkrim te sipermarresit sipas vendimit nr 1261 date 28.04.2010 te Keshillit Drejtues te AKEP.
- Shkrese e Albtelecom nr.1056/4, date 18.05.2010 drejtuar AKEP, mbi depozitimin e pretendimeve mbi mosmarreveshjen me Alban Tirana Nascendo.
- Proces verbali i mbajtur nga seanca degjimore midis paleve me 25.05.2010.
- Projektvendim i KD te AKEP “Për mbylljen e procedimit administrative per zgjidhje mosmarreveshje interkoneksioni te filluar me VKD nr.1261, date 28.04.2010 midis sipermarresit Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k dhe Albtelecom sh.a”(Projektvendimi);
- Raport permbledhes mbi projektvendimin (**Raport**);
si dhe,
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen,
- Bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP, bazuar ne ankesen e sipermarresit Alban Tirana Nascendo me Vendimin e Keshillit Drejtues nr. 1261, date 28.04.2010 vendosi per fillimin e procedimit administrativ per zgjidhje mosmarreshje interkoneksioni midis sipermarresit Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k dhe Altelecom sh.a;
2. Ne vijim te VKD nr.1261, date 28.04.2010 :
 - Alban Tirana Nascendo, me shkresen nr.12 prot, date 14.05.2010 (AKEP : Nr.2145/2 Prot, date 14.05.2010) ka depozituar pretendimet me shkrim ;
 - Altelecom me shkresen Nr.1056/4 prot, date 18.05.2010 (AKEP: Nr.2279 Prot, date 18.05.2010) ka depozituar pretendimet me shkrim.
 - Me date 25.05.2010, ora 10.00 ne ambientet e AKEP u zhvillua nje seance degjimore me te dy operatoret.
3. Nga pretendimet me shkrim te depozituara ne AKEP, vihet re se:
 - Sipermarresi Alban Tirana Nascendo Al me shkresen **nr.12 prot, date 14.05.2010 (AKEP : Nr.2145/2 Prot, date 14.05.2010)** sqaron se:
 - Marreshja e lidhur permban te gjitha termat teknike dhe financiare, perfshire rrugesimin e trafikut me CLI dhe cmimet perkatese, dhe gjithcka funksionon mire pervec rrugesimit te thirrjeve drejt rrjeteve celulare Shqiptare;
 - Altelcom ka vene ne dijeni verbalisht se ka qene ne proces marrveshje me operatoret mobile dhe se shume shpejt do te hapej sherbimi. Megjithe premtimet e shtyra, Altelcom ka zvarritur ne menyre te padrejte kete ceshtje dhe ka nxjerre pretendime te ndryshme si nevoja per leje nga operatoret mobile per terminimin e ketij trafikut dhe veshtiresia per tu implementuar teknikisht;
 - Ne aspektin teknik lidhja me Altelecom realizohet me SS7 dhe nder sherbimet e tjera percillet cdo here numri CLI i perdorimit te kartes, per terminimin e te gjitha thirrjeve kombtare dhe nderkombetare. Pretendimi i Altelecom per veshtiresite teknike nuk qendron pasi ATN ka qene gjithmone dakort qe rrugesimi te percjelle CLI ose bashke me CLI te vendoset numri i aksesit te kompanise;
 - ATN terminon thirrjet e Altelcom apo traziton ne rrjetin Altelcom drejt rrjeteve nderkombetare mobile dhe fiks me mijera minuta ne muaj me CLI origjinale te abonentit qe perdor karten, dhe ne asnje rast nuk kemi patur probleme per kete trafik te percjelle nepermjet Altelcom;
 - Nje argumet i rendesishem per pretendimet eshte fakti se Altelcom per karten e vete me parapagim Alblue ofron terminimin e thirrjeve drejt rrjeteve celulare duke ofruar dhe CLI perkatese, ndersa shprehet se nuk ka mundesi teknike ta realizoje per karten Alban Tirana. Pretendimi i Altelcom se ekziston nje marreshje direkte me operatoret celulare per kete sherbim, nuk qendron pasi asnje marrveshje e tille nuk eshte depozituar ne AKEP.
 - Altelecom, **me shkresen Nr.1056/4 prot, date 18.05.2010, sqaron se:**

- Albtelecom ne lidhje me tranzitimin drejt rrjeteve celulare ne Shqiperi i ka bere te qarte te gjitha OSHKP_THK-ve per veshtiresite teknike qe do te kishte dhe qe aktualisht ka per te gjitha palet: OSHKP_THK – Albtelecom (tranzitues) – Operatoret Mobile (terminues), implementimi i ketij sherbimi. Zgjidhja teknike nuk qendron vetem tek Albtelecom, por dhe ne bashkpunimin me OSHKP_THK dhe operatoret Mobile. Ne shume momente Albtelecom ka qene afer zgjidhjes se ketij problemi, por pengesa ka qene nese tranzitimi do te behet me CLI e kodit te aksesit te operatorit (0801 xxx) apo me CLI e perdoruesit fundor qe perdor karten. Zgjidhja e ketij problemi nuk qendron vetem tek Albtelecom por edhe ne bashkpunimin me OSHKP-THK dhe operatoret celulare, qe kerkon perputhshmeri te mundesive teknike te tre paleve, nderkohe qe OSHKP_THK nuk kane ofruar asnje zgjidhje/propozim konkret;
- Krahasimi i tranzitimit midis OA te rrjeteve fikse dhe OC me tranzitimin OSHKP_THK-Celulare nuk eshte i drejte, pasi nuk mund te behet analogji midis dy llojeve te tranzitimit: OA te rrjeteve fikse kane numeracionin e tyre dhe tranzitimi i thirrjeve realizohet me CLI e perdoruesve te tyre fundore, evidentimi i operatorit kryhet nga serite numerike te operatorit perktes. Ne rastin e OSHKP-THK, perdoruesit fundore jane te Albtelecom dhe kjo con ne veshtiresi ne evidentimin e trafikut drejt dhe me operatoret terminues, te cilat jane shume te rendesishem per percaktimin e detyrimeve financiare te paleve te interkonektuara;
- Albtelecom menaxhon marredhenie me mbi 80 subjekte te aksesuar dhe interkonektuar ne rrjetin e tij dhe nuk mund ti pergjigjet interesave individuale pa u siguruar qe kjo nuk do te efekteje teknikisht te gjitha lidhjet e tjera te aksesit dhe interkoneksionit ne lidhje me evidentimin e trafikut te shkembyer;
- Ne kuader te liberalizimit te tregut ATN ka mundesine e zgjedhjes se tranzituesit si dhe mundesine e lidhjes direkte me operatoret celular. Albtelecom sqaron se Alban Tirana Nascendo Al eshte i lire te zgjedhe rruge alternative per t'i ofruar kete sherbim perdoruesve te tij te kartes , sic aktualisht ben nepermjet teknologjise VoIP;
- Albtelecom eshte i detyruar te propozoje qe ATN te realizoje lidhje indirekte apo direkte me operatoret celulare, per shkak te problemeve teknike, si edhe per shkak te interesave ekonomike te Albtelecom:
 - Tarifat e tranzitimit ne Albtelecom jane nen-kosto;
 - Tarifat me pakice nuk jane te ribalancuara, duke rezultuar ne pajtim mujor nen-kosto;
 - Origjinimi i thirrjeve drejt OSHKP ka kosto me te larte se ndaj numrave gjeografike per shkak te angazhimit te me shume burimeve te rrjetit;
 - Albtelecom megjithese eshte i gatshem te bashkepusoje me OSHKP_THK, operatoret celulare dhe AKEP per gjetjen e zgjidhjes, propozon qe detyrimet rregullatore per Albtelecom per

akses dhe interkoneksion per OSHKP, te limitohen vetem ne origjinim e thirrjeve (sherbim i cili ofrohet aktualisht dhe si shume sherbime te tjera nen-kosto-dhe kjo kerkon nje rregullim shtese per tarifen).

4. Nga diskutimet ne seancen degjimore:

ATN eshte shprehur se:

- Albtelecom e ka kryer per nje periudhe tre vjecare nga viti 2003 deri ne 2006 dhe eshte mbyllur ne vitin 2006, pra eshte implementuar. Aksesimi eshte krejtesisht i matshem. Albtelecom, duhet te komunikojte si deshiron ti vijne thirrjet dhe ATN eshte e gatshme ta zbatoje;
- Zgjidhjet alternative per tranzitimin e thirrjeve drejt celulareve, nuk jane te mira, pasi ato nuk sigurojne nje cilesi te mire, kane kosto te larte dhe si rrjedhoje nje cmim me te larte per abonentin dhe trafik te limituar per ATN.
- Tarifat per tranzitim me operatore te tjere eshte shume me i larte se Albtelecom si OFNT;

Albtelecom eshte shprehur se:

- Albtelecom nuk eshte kunder tranzitimit te kerkuar, por nuk jane te sigurt mbi fshehjen e thirrjeve te tranzituara. Per sa i perket privimit te abonenteve te ATN, kjo nuk eshte e vertete, pasi ATN ka mundesi te tjera per zgjidhjen e ketyre problemeve, dhe aktualisht ATN ofron thirrje drejt celulareve.
 - Problemi qendron ne veshtiresit teknike, qe ka hasur Albtelecom per implementimin e rrjetit. Ne treg ka 76 operatore, qe kerkojne tranzitim te thirrjeve ne 500 destinacione te ndryshme dhe qe Albtelecom duhet te masi, per keto operatore dhe per thirrje te ndryshme, te cilat mund te jene te kategorive te ndryshme;
 - Albtelecom, cmon qe AKEP te nderhyje, per zgjidhjen e mosmarreshjes, pasi zbatimi praktik i ketij sherbimi eshte i pamundur dhe kerkon shume burime, per implementimin dhe per keto arsye Albtelecom kerkon nje kompesim, per keto lloje implementimesh dhe mirembajtjesh.
5. Marreshjet e lidhura midis Albtelecom – OSHKP_THK jane te njejta dhe sherbimi i tranzitimit te thirrjeve drejt celulareve megjithese eshte i parashikuar ne keto marreshje nuk i ofrohet asnje OSHKP_THK tjeter (trajtimi i njejte per te gjitha operatoret);
 6. Per karten me parapagim te Albtelecom Albablu, realizohet tranzitimi dhe terminimi i thirrjeve drejt dhe ne rrjetet celulare, duke derguar CLI e abonentit te Albtelecom;
 7. RIO e Albtelecom miratuar nga AKEP me 10.02.2009, ne lidhje me sherbimet e ofruara OSHKP-ve permban :
 - a. Detyrimin e Albtelecom per te ofruar sherbimin e origjinimit te thirrjeve nga perdoruesit fundore (Abonentet) te Albtelecom per

- ofruesit e shërbimeve me karte të parapaguara (OSHKP) me tarifata të dhëna në Aneks 2;
- b. Detyrimin për terminimin e thirrjeve që rrëzohen nga OSHKP në rrjetin Albtelecom për terminimin në rrjetin Albtelecom, me tarifa të terminimit sipas segmenteve të terminimit në rrjetin Albtelecom të përcaktuara në Aneks 2;
 - c. Detyrimin e Albtelecom për të ofruar shërbimin e tranzitimit të thirrjeve nga përdoruesit fundorë (Abonentet) e operatorit përfitues drejt ofruesit të shërbimeve me karte të parapaguara (OSHKP) të autorizuar nga AKEP të cilët janë të hostuar në rrjetin Albtelecom nëpërmjet një numri jo-geografik aksesi në formatin 0801XXX. Për këtë shërbim OSHKP paguan Albtelecom:
 - Për tranzitimin e thirrjeve sipas segmenteve të tranzitimit kombëtar të përcaktuara në pikën 3.1.2.1 në varesi të vendodhjes së pikave të interkoneksionit të Albtelecom me operatorin përfitues dhe OSHKP, dhe me nivelin e tarifave përkatëse të tranzitimit të dhëna në Aneks 2, dhe
 - Për origjinimin e thirrjeve në rrjetin e operatorit përfitues sipas marrëveshjes së rene dakort midis operatorit përfitues dhe OSHKP;
8. Fakti që tarifata për tranzitim nga operatorë të tjerë është shumë më e lartë se Albtelecom si OFNT, si dhe lidhja direkte me OC do të ishte me shumë kosto pasi tarifata fikse janë shumë më të larta për interkonektimin direkt me operatorët celularë dhe saisa e trafikut nuk e justifikon një lidhje të tillë, tregon që tarifata e Albtelecom për tranzitim janë nën-kosto dhe nën nivelin konkurrues, dhe kanë efekt negativ për Albtelecom dhe për tregun;
9. Në kushtet kur :
- a. AKEP me vendimin nr. VKD nr.1348, datë 26.07.2010, ka vendosur detyrimin për Albtelecom për ofrimin e origjinimit, terminimit si edhe tranzitimit të thirrjeve kombëtare të OSHKP, duke përcaktuar dhe tarifata respektive;
 - b. AKEP me Vendimet e KD nr. 1210, datë 31.03.2010 i ndryshuar për AMC, nr. 1211, datë 31.03.2010 i ndryshuar për Vodafone dhe nr.1212, datë 31.03.2010 i ndryshuar për Eagle Mobile, ka vendosur që terminimi i thirrjeve kombëtare në këto rrjete është nën-rregullim me tarifata përkatëse;
- është e arsyeshme që:
1. Albtelecom të tranzitojë thirrjet e ofruesve të shërbimeve me karta të parapaguara drejt rrjeteve celulare sipas tarifave të dhëna në vendimin nr.1348, datë 26.07.2010;
 2. Operatorët celularë me FNT për terminimin në rrjetet e tyre duhet të japin akses në rrjet për terminimin e thirrjeve të gjeneruara nga përdoruesit kartave me parapagim, pasi janë thirrje kombëtare të origjinuara në RSH, dhe me tarifata përkatëse të kontrolluara nga AKEP.
10. Identifikimi i CLI është një proces i rëndësishëm, dhe CLI e përdoruesit fundorë duhet të përcillet së bashku me identitetin (Kodin) e operatorit

OSHKP. Ne kete proces eshte i nevojshme bashkepunimi midis te gjitha paleve te intersuara;

11. Ne baze te vendimeve te shpalljes me FNT te Albtelecom dhe tre operatoreve celulare, keta operatore duhet te pergatisin ofertat reference te interkoneksionit dhe me pas te lidhin MI bazuar ne keto oferta refernce;
12. Ne sancen degjimore te zhvilluar nga KD me 26.07.2010, me pjesmarrjen e Albtelecom, Alban Tirana NAscendo dhe kater opertaoret celulare (si pale te interesuara):
 - a. Albtelecom deklaroi se nuk eshte i gatshem te ofroje shembime me tarifa nen-kosto dhe ne kushtet e tarifave jo te balancuara te perdoruesve me pakice, detyrimi per te dhene akses per OSHKP, per origjinim dhe per tranzitim eshte jo-proporcional. Gjithahstu Albtelecom u shpreh se zgjidhja e mosmarreveshjes varet nga sjellja e operatoreve celulare te cilet shpesh jane pengese ne ofrimin e kapaciteteve te nevojshme per interkoneksion me Albtelecom, duke ju referuar dhe procedimeve administrative te nisur nga AKEP me VKD nr. 1279, date 20.05.2010, dhe ankesave te Albtelecom per ceshtjen e tranzitimit me operatoret celulare;
 - b. Alban Tirana Nascendo u shpreh i gatshem te bashkepunonte per ceshtjen e CLI dhe se pranonte projekt-vendimin e AKEP;
 - c. Operatoret celulare u shprehen se per tranzitimin e trafikut drejt rrjeteve te tyre, ata duhet te njoftohen per sasine qe do tranzitohet dhe kapacitetet e nevojshme, si dhe kerkuan me shume kohe se data 1.10.2010 per implementim/zgjidhje teknike per shkak te axhendes se ngjeshur;
 - d. Albtelecom dhe operatoret celulare u shprehen se ne lidhje me zgjidhjen per CLI te propozuar nga AKEP, duhet te konsultoheshin me departamentet teknike, megjithese zgjidhja e propozuar u ishte njoftuar 10 dite perpara sipas afateve te rregullores se mosmarreveshjeve.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar ne piken 1 te nenit 114 dhe piken 1 te nenit 115, te ligjit nr. 9918, nenin 140 e vijues te K.Pr.A, si dhe piken 17 te nenit 21 te Rregullores se Brendshme,

V E N D O S :

1. Te mbylle procedimin administrativ per zgjidhje mosmarreveshje interkoneksioni midis Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k dhe Albtelecom sh.a” te nisur me VKD nr.1261, date 28.04.2010;
2. Sipermarresi Albtelecom sh.a. ne baze te percaktimeve te vendimit te KD nr.1348, date 26.07.2010, te perfshije sherbimin e tranzitimit te thirrjeve te ofruesve te kartave me parapagim, te gjeneruara nga abonentet e Albtelecom, ne oferten reference te interkoneksionit te perditesuar;

3. Shërbimi i tranzitimit të thirrjeve të ofruesve të kartave me parapagim, të gjeneruara nga abonentet e Albtelecom, drejt rrjeteve celulare të kryhet me CLI të abonentit të Albtelecom duke mundësuar përcjelljen e identitetit të ofruesit të shërbimeve me karte të parapaguara;
 4. Zbatimi i detyrimeve të mesiperme të kryhet nepermjet:
 - a. Nenshkrimin të marrëveshjes së interkoneksionit të re apo të amenduar midis Albtelecom dhe Alban Tirana Nascendo, bazuar në ofertën referencë të përditësuar të Albtelecom sipas përcaktimeve të Vendimit nr.1348, datë 26.07.2010;
 - b. Nenshkrimin të marrëveshjeve të interkoneksionit të reja apo të amenduara midis Albtelecom dhe operatorëve celularë me FNT, bazuar në ofertat referencë respektive të interkoneksionit të operatorëve Albtelecom, Vodafone Albania, AMC dhe Eagle Mobile të përditësuara sipas përcaktimeve të Vendimeve përkatëse për shpalljen me FNT të tyre, dhe sipas negociatave komerciale për thirrjet drejt Mobile 4 Al.
 - c. Kapacitetet e interkoneksionit midis Alban Tirana Nascendo/OSHKP-ve të tjera dhe Albtelecom si edhe midis Albtelecom dhe operatorëve celularë të përcaktohen sipas kushteve të ofertave referencë të interkoneksionit dhe pa-diskriminim në raport me operatorët e rrjeteve publike fikse/celulare.
 5. Ofrimi nga Albtelecom i shërbimit të tranzitimit të thirrjeve të ofruesve të kartave me parapagim, të gjeneruara nga abonentet e Albtelecom, drejt rrjeteve celulare, të bëhet efektiv pas nenshkrimin të marrëveshjeve të cituara në pikën 4 më sipër, dhe në të njëjtën kohë për Alban Tirana Nascendo dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve me karte të parapaguara me të cilët është nënshkruar marrëveshja/amendimi përkatës i cituar në pikën 4, por jo më vonë se 1.11.2010.
 6. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al
- Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**